



Prishtinë: 17.12.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1470_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2259_11_21** të dt. 05.11.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 19.11.2021;

në seancën e mbajtur më datë 17.12.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit A. K., nga Komuna e Prizrenit.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2259_11_21, i datës 05.11.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRRE me datë 05.11.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2259_11_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit A. K., nga Komuna e Prizrenit, lidhur me kontestimin e faturës së dt. 25.04.2020 dhe e ka obliguar KESCO-n, që për këtë faturë, t'i ofroj konsumatorit kontratë pagese prej katërmëdhjetë (14) muajve.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori A. K., brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së për këto shkaqe:

- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së është i bazuar në prova të pavërteta, dhe se konsumatori nuk mund ta pranojë këtë borxh sepse ka bërë disa herë kërkesa për lidhje në rrjetin e energjisë elektrike;
- Shpenzimi i faturuar është shumë i lartë, dhe se konsumatori nuk ka pranuar asnjë dokument se sa kilovat orë i ka shpenzuar me njehsorin e kaluar;
- Nga krahasimi i shpenzimeve me njehsorin e ri dhe me njehsorin e vjetër është shumë i madh;
- Konsumatori kërkon që vendimi i DMK-së të anulohet;

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë në ZRRE është i bazuar në prova të pavërteta, Bordi i vlerëson si jo të qëndrueshëm, për faktin se, pas analizimit të



procesverbalit të dt. 29.07.2017, procesverbalit të inspektimit të dt. 07.06.2018 dhe procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt. 05.02.2020 dhe ka gjetur se, fillimisht konsumatorit nuk ka mundur që t'i vendoset njehsori elektrik sepse nuk ka tension afër dhe tensioni elektrik ka qenë në largësi mbi 150m. Pas inspektimit të dytë, është konstatuar se, konsumatorit nuk mund t'i vendoset njehsori elektrik, sepse teknikisht konsumatori nuk e ka vendosur kabllon mirë, kabloja ka qenë e vendosur në një leftë druri. Më pas është ndërruar njehsori dhe njehsori i vjetër është dërguar për kontrollë në qendër të kalibrimit. ZRrE gjithashtu ka analizuar faturat, ankesën e konsumatorit dhe Përgjigjen e KESCO-s, si dhe provat tjera materiale si në shkresat e lëndës, andaj, pretendimit që ZRrE e ka bazuar vendimin në prova të pavërteta, nuk qëndron.

Më tej, Departamenti i faturimit ne KEDS me datë 25.04.2020 i ka dërguar konsumatorit faturën e energjisë elektrike me **12,315 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **736.23€**. ZRrE bazuar ne rrjedhën e energjisë elektrike si dhe procesverbaleve te inspektimit përfshi edhe procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0830857 datë 05.02.2020 konstaton se kjo faturë është si rrjedhojë e kWh te regjistruar ne njehsorin nr. 20017941 dhe se ne asnjë mënyrë nuk paraqet shpenzim real mujor te konsumatorit. Andaj, duke e pasur parasysh kWh e regjistruara ne procesverbalin nr. 0830857 datë 05.02.2020 si dhe mesataren e shpenzimeve te konsumatorit nga periudha 04/2020 deri me 10/2021 prej **490 kWh/muaj** ka bere shpërndarjen e kWh te faturuar ne faturën nr. 0420153861DPZ-9071856 për periudhën 25 mujore, por qe konstaton se konsumatorit nuk i takon korrigjim financiar.

Konsumatori ne ankesën e tij thekson se njehsorin nr. 20017941 është detyruar ta vendos vet për shkak se ekipet e KEDS-it edhe pas inspektimit te dytë nuk kanë bere pranimin teknik te kabllit i cili është shtrire dhe se thekson se ky njehsor është vendosur për afërsisht 20 muaj para regjistrimit te njehsorit nr. 20056814 i cili është vendosur nga KEDS. Konsumatori po ashtu ne ankesën e tij thekson se dëshiron qe t'i kthehet njehsori i vjetër me qellim qe te beje krahasimin e kWh te faturuar dhe se te njëjtin e ka blerë me mjete te veta financiare. ZRrE e informon konsumatorin se ekziston procesverbali mbi ndërrimin e njehsorit elektrik ne te cilin është e vendosur shpenzimi i regjistruar ne njehsorë dhe se ky procesverbal është nënshkruar nga ai kurse sa i përket pronësisë se njehsorit bazuar ne Ligjin per Energji Elektrike nenin 53 paragrafi 2 dhe 3 rregullohet përgjegjësia e vendosjes se njehsorëve matës ku thuhet se: *Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcaktojnë tipin, numrin dhe vendin e montimit të pajisjes matëse si dhe kontrollin përkatës dhe mënyrat e komunikimit. Gjatë përcaktimit të vendit të montimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të sigurohen që qasja në njehsor të vihet në dispozicion për qëllime të mirëmbajtjes dhe leximit të pajisjeve matëse, 3. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalojnë pajisjet matëse. Në rast se konsumatorëve ose prodhuesve u lejohet të zgjedhin llojin dhe tipin e pajisjes matëse, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet ta instalojnë pajisjen e tillë me kusht që të specifikohet me shkrim se një gjë e tillë është bërë në pajtim me Kodin e Matjes, kurse neni 54 paragrafi 1 përcakton pronësinë e sistemeve matëse e ku thuhet se: Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë.*



Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRRE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit A. K., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.